
 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	<b>KRYETARI I KOMUNËS          PRESEDNIK OPŠHTINE          MUNICIPAL MAYOR</b>		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01- 670 /022	Data: Datum: 09.09.2022	

Kryetari i Komunës, në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008) dhe bazuar në nenin 8 të Rregullores MF 4/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, shqyrtoj kërkesën 09.Nr.204/2022 të datës 08.09.2022, të parashtruar nga Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi, për themelimin e komisionit për vlersim të aplikimeve të OJQ-vë, me projekte qëllimi i të cilit është Vlersimi i projekteve të OJQ-ve për organizimin e aktivitetit tradicional, Dita e Mollës 202, që kanë aplikuar në thirrje publike të datës: 19.08.2022, dhe nxjerr:

## V E N D I M

**1. THEMELOHET:** Komisioni për vlersimin e projekteve të OJQ-ve të cilët kanë aplikuar në thirrje publike për “Mbeshtetje financiare për projektet e OJQ-ve për organizimin e aktivitetit tradicional, Dita e Mollës 2022” të publikuar me 19.08.2022, dhe në komision caktohen:

- 1.1. **Valbone Kaliqani**, zyrtare e lartë për pentari, Kryesuese e komisionit;
- 1.2. **Besnik Metaj**, përfaqesues i drejtorisë së financave, anëtar;
- 1.3. **Ermir Çitaku**, përfaqesues i OJQ-ve, anëtar,
- 1.4. **Armend Gashi**, expert i jashtëm, anëtar;
- 1.5. **Arlind Balaj**, zyrtar ligjor, përfaqesues i drejtorisë së financave, anëtar;

Anëtar rezervë i komisionit;

- 1.1 **Kaltrina Kukleci**, zyrtare për subvencione,

2. Komisioni i cekur me lartë, ka për obligim që të bëjë vlerësimin e aplikimeve të projekteve të OJQ-ve të cilët kanë aplikuar në bazë të thirrjes publike për mbështetje financiare të OJQ-ve të datës 19.08.2022, të përpiloj listën e OJQ-ve aplikuese dhe ti rendit sipas pikëve të fituara gjatë vlerësimit të aplikimit.
3. Me listën e përpiluar dhe raportin e vlersimit të njofton Kryetarin e Komunës dhe Drejtorin për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi, si dhe do t'i kryejë punët dhe përgjegjësit tjera të cilat janë në natyrën e këtij komisioni.

4. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë dhe për realizimin e tij do të kujdesen: Komisioni për vlerësimin e projekteve dhe Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi.

5. Ky vendim është përfundimtar.

**Vendimi i dërgohet:**

- Anëtareve të Komisionit,
- Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi dhe
- Arkivi i zyrës së Kryetarit.

**Kryetari Komunës**  
**z. Ilir FERATI**

